



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 41 dt.08.05.1995

**PER  
RRITJEN E PAGAVE TE KESHILLIT DREJTUES DHE DREJTORIT  
TE QENDRES SPORTIVE TE TIRANES.**

Këshillit Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.08.05.1995, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Seksionit të Fizkulturës për rritje e pagave të këshillit të drejtorisë dhe të drejtorit të Qendrës Sportive të Tiranës. Në zbatim të vendimit të KM Nr.463, dt.03.10.1994 dhe në zbatim të vendimit të KM Nr.345, dt.10.03.1992, Këshilli Bashkiak mbështetur në kompetencat që i jep ligji “Për ndërmarrjet shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.5 dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10

**VENDOSI**

1. Drejtorit të Qendrës Sportive Tirana ti jepet rroga mujore prej 9.000 lekësh.
2. Për anëtarët e tjerë të këshillit të drejtorisë paga të vendoset 12 – 20% më e vogël së paga e drejtorit.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**